

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -



EKO KLUBI
"LUCIANO MOTRONI"

1





Të dashur lexues,

EC ka filluar publikimin e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë "Luciano Motroni" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

KUR PUSHOI BOTA

Në shtatë kontinentet e këtij globi,
Cep më cep të kësaj gjeografie,
Pa dallim race apo etnie,
Ne botën do ta shkatërrojmë.

Do nxjerrim gjithë minierat e qymyrin,
Do ham gjithë gjallesat detare,
Të kënaqim apetitet,
E kësaj bote kalimtare.

Premë drunjtë, i bëm mobilje,
Ndërtuam fabrika që ndotin lumenj,
E po nga i njëjti lum,
Do ham peshk, specialitet.

Elektranat nxinë qiellin,
Makinat nxinë rrugët,
Zi po pijmë zi po hamë,
Kemi filluar dhe zi të shohim.

Dhe ashtu një ditë prej ditëve,
Armik i padukshëm na rrethoi,
Pandemi e paska emrin,
I gjithë populli e mallkoi.

Rrugët na zbrasi e frikën na futi,
Përqaftimin ndaloi,
Shëtitjet na kufizoi,
Maskë e doreza të vemë na detyroi.

Harruam lukset, i'u kthjem familjes,
Frikë e vdekjes kaploi botën
Harruam lukset, i'u kthjem vetes,
Nga frikë e urisë e urisë zbrazem
marketet.

Dhe në këto momente kur bota pushoi:
-Pyjet nuk u pren më
-Lumenjt nuk u ndotën
-Makinat pushuan për herë të parë
-Lakmia pushoi për herë të parë

BOTA PUSHOI PËR HERË TË PARË

YLLZA KRASNIQI



INTERVISTË ME DREJTORIN E SHKOLLËS, EKOLOG



MEHDI KRASNIQI
DREJTOR, BIOLOG, EKOLOG

1. CILA ËSHTË ÇËSHTJA MË URGJENTE MJEDISORE AKTUALISHT?

- Prej çështjeve mjedisore më urgjente aktualisht me të cilat duhet të merret njerëzimi mendoj se është ruajtja e biodiversitetit.

2. ÇFARË JU BËRI TË VENDOSNI TË VAZHDONI KARRIERËN TUAJ SI EKOLOG?

- Pasioni dhe dëshira për të kontribuar në ruajtjen dhe kujdesin ndaj natyrës dhe botës së gjallë bimore dhe shtazore, mbrojtja dhe shfrytëzimi në mënyrë të kontrolluar i burimeve dhe resurseve natyrore.

3. CILA ËSHTË ÇËSHTJA MË E RËNDËSISHME MJEDISORE QË NJERËZIT PËRJETOJNË AKTUALISHT?

- Prej çështjeve mjedisore më aktuale në vendin tonë dhe në botë mendoj se është ngrohja globale, humbja e biodiversitetit, sigurimi i ushqimit dhe ujit të pijes.

4. SI DO TË JETË MJEDISI NË KOSOVË NË 10 VITET E ARDHSHME?

- Mendoj që në Kosovë ka shumë për tu bërë sa i përket mbrojtjes së mjedisit, në të ardhmen shoqëria e jonë duhet të vetëdijesohet lidhur me legjislacionin dhe kulturën e mbrojtjes së mjedisit, prandaj mendoj që ne do të shkojmë drejt përmirësimit, mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit jetësor.

INTERVISTË ME DREJTORIN E SHKOLLËS, EKOLOG

5. CILAT JANË KËRCËNIMET KRYESORE TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE?

- Ngrohja global (greenhouse efekt) ndryshimet klimatike janë kërcënimi më serioz që mundë ti shkaktohet planetit, shkrija e akullnajave ne veri do të ishte katastrofale për tërë planetin, qytetet bregdetare do të mbuloheshin nga uji, lëvizja e popullsisë, dyndjet, do të shkaktonin pasoja të rënda për gjithë planetin, pasoja të paparashikueshme.

6. SI PO NDIKOJNË NDRYSHIMET KLIMATIKE TE KAFSHËT DHE NJERËZIT?

- Ndryshimet klimatike kanë efekt të drejtpërdrejtë në njerëz dhe përgjithësisht botën e gjallë bimore e shtazore, më pak ujë, më pak reshje, thatësira etj...



7. SI NDIKON NDRYSHIMI I KLIMËS NË SHËNDETIN E NJERËZVE?

- Pasojat mjedisore të ndryshimeve klimatike, siç janë valët ekstreme të nxehtësisë, ngritja e nivelit të detit ndryshimet në reshjet që rezultojnë në përmbytje dhe thatësira, uragane intensive dhe cilësia e degraduar e ajrit ndikojnë drejtpërdrejtë dhe indirekt në shëndetin fizik, social dhe psikologjik të njerëzve.

INTERVISTËN E REALIZOI:

YLLËZA KRASNIQI, NXËNËSE E KLASËS XI-2,
UDHËHEQËSE E EKO KLUBIT TË SHKOLLËS

INTERVISTA ME BIOLOGUN E SHKOLLËS

**PROF. GAZMEND BEQAJ, BIOLOG,
MËSIMDHËNËS NË SHKOLLËN TONË.**

1. CILA ËSHTË PËRVOJA E JUAJ RRETH NDOTJES SË UJIT?

- Njerëzimi gjatë historisë së vet është përballur me shumë pasoja të ndotjes së ujit që ka rezultuar me paraqitjen e shumë sëmundjeve edhe në përmasa epidemike, por përvoja ime me ndotjen e ujit është shumë e kufizuar kryesisht në ndotjen e lumit të qytetit që ka ndikuar në zvogëlimin e biodiversitetit bimor dhe shtazor të lumit duke humbur kështu edhe atraktivitetin e tij.

2. CILAT KRIJESA PREKEN NGA NDOTJA E UJIT?

- Varësisht nga burimi i ndotjes mundë të preken këto apo ato grupe të organizmave, por në parim përmes zingjirit ushqimor mundë të preken të gjithë që nga protozoat, bimët shtazët por edhe njeriu.

3. SI NDIKON NDOTJA E UJIT NË TOKË?

- Ndotja e ujit ndikon në mbi 200 sëmundje, por në aspektin futurist nëse nuk menagjohet si duhet mundë të ketë pasoja katastrofale nga ndotja e ujit.

4. A MUND TË NDIHMOJË FILTRIMI I UJIT, PSE PO APO JO?

- Padyshim që filtrimi i ujit të pijes, filtrimi i ujërave të zeza ndihmon shumë në aspektin ekologjik.

5. ÇFARË DO TË NDODHË NËSE NUK I NDALOJMË SHPYLLËZIMET?

- Pyjet janë mushkëritë e tokës, prandaj nuk është e vështirë të kuptojmë ndikimin e shpyllëzimeve në planet, janë prodhuesit kryesor të oksigjenit në tokë.



INTERVISTA ME BIOLOGUN E SHKOLLËS

6. SI MUNDË TË NDIHMOJË NJË PERSON I VETËM PËR TË LUFTUAR SHPYLLËZIMIN?

- Edhe rrugëtimet e gjata nisin me hapin e parë, ndaj edhe një njeri i vetëm mundë të bëjë mjaftueshëm duke ftuar të tjerë rreth vetes rreth kauzës së përbashkët me qëllim të parandalimit të shpyllëzimeve.

7. ÇFARË MENDONI PËR SHPYLLËZIMET NË KOSOVË?

- Nuk do thoja se kanë arritur nivele alarmante, megjithëse shpyllëzime ka, më shumë së kjo vërehet një mungesë aktivitetesh vetëdijesuese për ruajtjen e pyjeve ose për ripyllëzime.

8. SI MENDONI, NDOTJA E PYJEVE A MUND TË PËRMIRËSOHET NË KOSOVË, PSE PO APO PSE JO?

- Ndotja e pyjeve në Kosovë mundë të përmirësohet, parasegjithash me vetëdijesimin e të gjitha palëve të interesuara për pasojat katastrofike që mund të ketë ndotja e pyjeve.



NGRITJA VETËDIJES QYTETARE LIDHUR ME MJEDISIN GJENDJA ALARMANTE LIDHUR ME SHKATËRRIMET E MJEDISIT NE KOSOVE

Vetëdija qytetare në Kosovë sa i përket mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit vazhdimisht duhet të ngritet. Pasojat e një mjedisi të ndotur janë jashtëzakonisht të mëdha, ndër faktorët më kryesor të ndotjes së mjedisit në Kosovë janë: kanalizimet (ujërat e zeza) industrinë sidomos prodhimi i energjisë elektrike duke shfrytëzuar thëngjillin si lëndë djegëse, hudhja e mbeturinave në vende jo të duhura-mosmenagjimi si duhet i tyre, mbeturinat e amvisërisë, detergjentet, shkatërrimi i shtretërve të lumenjve si dhe shpyllëzimet dhe djegia e pyjeve janë vetëm disa nga faktorët që ndikojnë në shkatërrimet e mjedisit në Kosovë.

Prandaj është detyrë imediate e gjithsecilit të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit duke filluar nga familjet, shkolla, shoqëria në përgjithësi e legjislacioni nga organet vendimmarrëse, të gjithë së bashku të kontribuojmë në parandalimin e rreziqeve më të mëdha mjedisore në mënyrë që mos të vijmë deri te ndonjë katastrofë ekologjike e shoqëruar me epidemi të ndryshme, prandaj sa më herët që shoqëria e jonë të vetëdijesohet lidhur me problemet mjedisore aq më mirë për shoqërinë tonë.





AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE EC MA NDRYSHE



EKO KLUBI "LUCIANO MOTRONI" RR. MEHMET PASHË DEVALLA – PRIZREN, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".